UDHËZIM
Nr. 793/6, datë 26.3.2013

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR NJOHJE DHE MIRATIM TË AGJENCIVE NDËRMJETËSUESE TË HUAJA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr. 9695, datë 19.3.2007 "Për procedurat e birësimit dhe Komitetit Shqiptar të Birësimeve", të ndryshuar, paragrafit 2 të nenit 11 të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 399, datë 1.6.2011 të Këshillit të Ministrave "Për përbërjen dhe rregullat e funksionimit të Komisionit të Miratimit të Agjencive Ndërmjetësuese të Huaja", Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave

UDHËZOJNË:

1. Tarifat për veprimet dhe shërbimet që kryen Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet Komisionit të Miratimit të Agjencive Ndërmjetësuese të Huaja, për njohjen dhe miratimin e agjencive ndërmjetësuese të huaja, caktohet në masën 5 000 (pesë mijë) lekë.
2. Për vjeljen e tarifave për veprimet dhe shërbimet për njohjen dhe miratimin e agjencive ndërmjetësuese të huaja, ngarkohet nga Ministria e Drejtësisë.
3. Tarifa për njohjen dhe miratimin e agjencive ndërmjetësuese të huaja paguhet në momentin e paraqitjes së kërkesës. Kërkesa duhet të shoqërohet edhe me dokumentin bankar që vërteton pagesën.
4. Tarifa e paguar nuk kthehet kur agjencisë ndërmjetësuese të huaj i refuzohet kërkesa për njohje dhe miratim.
5. Mbi tarifat për veprimet dhe shërbimet që kryen Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet Komisionit të Miratimit të Agjencive Ndërmjetësuese të Huaja, për miratimin e agjencive ndërmjetësuese të huaja, nuk aplikohet TVSH.
6. Tarifat e arkëtuara derdhen në llogarinë e të ardhurave përkatëse të thesarit të Ministrisë së Drejtësisë dhe kalojnë 100 % (një qind për qind) në Buxhetin e Shtetit.
7. Ngarkohet Komisioni i Miratimit të Agjencive Ndërmjetësuese të Huaja, si dhe strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode